

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SUHAREKË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	624-26-3537-5-2-1
Nr i brendshëm	624-26-25-521

Sa i përket tenderit për Titulli: **Ndertimi i rrugëve lokale 3 Lot - Terrnje, Mohlan, Dvoran**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

GOE BVL KO (Lendrit Kokollari B.I.); REXHA SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr Sylejman Vuqeterna Nr03, LI-2, K/O

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

049562252

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Lendrit Kokollari

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Bvl-ko@outlook.com (Adresa elektronike)

09.09.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.



¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftim per Kontrat, 15.05.2026

B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve 05.06.2026

B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues, 01.07.2026

Vendimi të kërkesës për rishqyrtim:06.07.2026

Ankese ne Oshp(procedura kthehet ne Rivlersim) referenc 496/2026

**B58 NJOFTIM MBI VENDIM I AUTORITETIT KONTRAKTUES RRUG 3 LOT TERRNJE
MOHLAN DVORAN RIVLERSIM.pdf 27.08.2026**

-Kerkese per rishqyrtim

Vendimi per refuzim 02.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Bashkangjitur keni Kërkesat për rishqyrtim te vendimit te AK

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji nr 04/L-042, i amendamentuar.

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi;
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;
- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;
- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës;

- Neni 27 i LPP-së- Dosja e tenderit
- Neni 57 Sigurimi i Tenderit

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi

Mendojmë se Autoriteti Kontratues ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 1 të LPP-së duke mos respektuar procedurat ligjore, për shkak që n' akeni eliminuar për kunders faktit që ne l kemi permbush kerkesat e percaktuara ne DT dhe duke mos zbatuar procedurat që duhet të ndiqën për të zbatuar qëllimin e LPP-së.

- Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;

Pretendojmë se Autoriteti Kontratues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të nenit 7 të LPP-së për shkak që keni rekomanduar OPERATOR EKONOMIK me ofetë me të lart se oferta jone për kunders faktit që ne l kemi permbush kriteret e percaktuara ne D.T. gjithashu na keni diskriminuar duke na eliminuar duke mos zbatuar procedurat që duhet të ndiqën për të zbatuar LPP-së.

- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Pretendojmë se Autoriteti Kontratues ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 56 të LPP-së , duke mos vlersuar konform kerkesave te percaktura ne dosje te tenderit.

- Neni 59 i LPP-së- Ekzaminimi, Vlersimi dhe Krahassimi i Tenderëve

Pretendojmë se Autoriteti Kontratues ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 59 të LPP-së për shkak që ekzaminimi dhe vlersimi i tenderit është bërë në mënyr të njëanshëm.(Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues)

- Neni 60 i LPP-së- Kriteret për Dhënien e Kontratës

Mendojmë se Autoriteti Kontratues ka bërë shkelje nenit 60 pikes 1.1 të LPP-së duke mos respektuar procedurat ligjore, për shkak që keni REKOMANDUAR nje operatoret ekonomik tecilet kan oferta me te lartë se oferta jon per LOT 1 PER LOT 2 DHE PER LOT 3, ne kundrshtim me kriteret e percaktuar vet në D.T njëherit duke e demtuar bugjetin ekomunes.

Gjithashtu dhe kriterine e percaktur nga vet AK duke e rekomanduar te njejtin operator ne te tri llotet per kunders faktit se ne jemi te pergjegjshëm në njërin lot.

- Neni 27 i LPP-së- Dosja e tenderit

Mendojmë se Autoriteti Kontratues ka bërë shkelje nenit 27 LPP-së duke mos respektuar procedurat ligjore dhe kriterin e percaktur nga vet ju duke e rekomanduar te njejtin operator ne te tri llotet.

- Neni 57 Sigurimi i Tenderit

Mendojmë se Autoriteti Kontratues ka bërë shkelje të nenit 57 LPP-së duke mos respektuar procedurat ligjore dhe rregullat që percaktohen ne ket nen.

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datën 27.09.2026, Autoriteti Kontraktues – Komuna Suharekë, ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK— **B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues-Rivlersim**, Andaj bazuar ne nenin 108/A, të LPP-së, paraqesim këtë:

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Autoriteti Kontraktues (AK) ka bërë shkelje të dispozitave ligjore duke rekomanduar për kontratë një operator ekonomik që ka paraqitur ofertë me çmim më të lartë se oferta jonë, duke mos zbatuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Rregullores së Prokurimit Publik (RRPP), përkundër faktit se ne, si Grup i Operatorëve Ekonomikë (GOE), kemi ofruar çmimin më të ulët dhe njëkohësisht i plotësojmë të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Pretendimi nr 1

Pretendojmë se ka rekomanduar për kontratë në të tri lotet të njëjtin operator ekonomik për kunder faktit që e ka pas përcaktuar në dosje të tenderit të shpërblehet vetëm një lot.

Ndarja në Lote	2.3	Ndarja në Lote: Po ☒ Jo ☐ <i>Objekti i tenderit është i ndarë në pjesë (lote) shëno:</i> Objekti i kontratës është i ndarë në 3 pjesë (lote). Tenderuesi mund të paraqesë tender për: ☒ Të gjitha pjesët Secila pjesë e lot-it është e shënuar në specifikacionet teknike , shih Aneksin 1. Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është: 1
----------------	-----	--

Komisioni vlersimit dhe Zyrtari I prokurimit ka vepruar ne kundërshtim me kërkesat e vetpërcaktuara ne dosje te tenderit te Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË Tenderit (FTD), sepse ne jemi te përgjegjeshm dhe do te duhej qe te rekomandoheshim per kontrate në njerin lot.

Pretendimi nr 2

Ky pretendim dëshmon qartë keqinterpretimin e qëllimshëm dhe absurd të rregullave të prokurimit publik nga AK.

- Mungesa e përcaktimit të shumës fikse në Dosjen e Tenderit: sipas nenit 57 të LPP dhe Sipas Neni 28, paragrafët 28.3 dhe 28.4 të Rregullores për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues ka detyrimin e prerë që kushtet të parashtrohen qartë në dosjen e tenderit dhe shuma e sigurimit të theksohet si shumë fikse dhe jo si përqindje. Megjithatë dosja e tenderit ka qenë plotësisht e heshtur dhe nuk ka përcaktuar asnjë shumë fikse apo kriter, çdo pretendim apo kërkesë e mëvonshme e AK-së përbën ndryshim të rregullave të lojës gjatë procesit dhe është e paligjshme.
- Përmbushja e minimumit ligjor prej 1,000 Euro: Pavarësisht mungesës së plotë të kriterëve në dosje, ne kemi ofruar polici sigurimi në vlerë prej 1,000 Euro, e cila përkon saktësisht me kufirin minimal absolut të përcaktuar me rregullore (Neni 28.4), ku theksohet se shuma në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se 1,000 Euro.
- Sipas Neni 57 Sigurimi i Tenderit, pika 3. Nëse autoriteti kontraktues vendos që të detyrojë depozitimin e sigurisë së tenderit, shuma e sigurisë së tillë duhet të jetë jo më pak se tri përqind (3%) dhe jo më shumë se pesë përqind (5%) e vlerës së parashikuar të kontratës publike ose konkursit të projektimit, por sidoqoftë, në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se një mijë (1.000) Euro.
- 4. Nëse autoriteti kontraktues vendos kusht për siguri të tenderit, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit:
 - 4.1. të gjitha kushtet në lidhje me natyrën, formën, shumën si dhe kushtet e tjera për sigurinë e tenderit; me kusht që, të gjitha kushtet e tilla të jenë në pajtim me këtë ligj dhe rregullat e prokurimit publik;
 - 4.2. shuma e saktë e sigurimit të tenderit dhe periudha e nevojshme e vlefshmërisë për sigurimin e tenderit;
 - 4.3. afati kohor për pranimin e sigurimit të tenderit, që është i njëjtë me atë për pranimin e tenderëve.

- Duke u bazur nën 57 të LPP-Së, ak ka bërë shkeleje pasi nuk e ka përcaktuar Shumën në dosje të tenderit edhe pse ligji e thotë qartazi se shuma duhet të theksohet. Në dosje të tenderit e jo në Njoftim për kontratë siç pretendon AK. Prandaj ne jemi të përgjegjshëm në njerin lot dhe kërkojmë nga Oshpe të marrë vendim dhe të URDHEROJ autoritetin Kontraktues që në njërin Lot të rekomandojë për kontratë GOE: BVL KO (Lendrit Kokollari B.I.); REXHA SHPK

- Paarsyeshmëria e kërkesës për sigurim të ndarë për secilin lot kur lejohet vetëm një fitues: Qëllimi kryesor i sigurimit të tenderit, sipas Nenit 28.1, është të shërbejë thjesht si mbulesë se operatori ekonomik ofron informata të vërteta, mban validitetin, respekton kushtet para nënshkrimit dhe përmbyll kontratën. Kriteri i vendosur nga vetë AK-ja përcakton qartë se një operator ekonomik mund të shpallet fitues vetëm në njërin lot. Kërkesa absurde e AK-së që ne të sjellim sigurim tenderi për të tria llotet është në kundërshtim të plotë me logjikën e prokurimit dhe parimin e proporcionalitetit. Përderisa ne nuk mund të shpallemi fitues në të tria llotet njëkohësisht, detyrimi për të bllokuar fonde ose për të paguar sigurime shtesë për llotet ku nuk mund të lidhim kontratë përbën barrë financiare të pajustificuar dhe diskriminuuese edhe pse shuma e sigurisë prej 1000 euro e mbulon vlerën minimale sipas LPP-së për të 3-lotet.

Shiko kërkesen ne Dosje te Tenderit:

Siguria e tenderit	13.1	A është e nevojshme siguria e tenderit: Po ☒
	13.2	Vlera e sigurisë së tenderit Vlefshmëria e sigurisë së tenderit ne ditë 90 apo muaj
	14.1	...

Andaj, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit-Paneli shqyrtues që të krahasojë dhe ekzaminojë në detaj këtë lëndë, duke marrë një vendim të prerë dhe detyrues për Autoritetin Kontraktues, me qëllim që të ndalet kjo praktikë e shkeljeve të vazhdueshme dhe zvarritjes së qëllimshme të procesit, pasi shihet qartazi se AK po vazhdon me veprime tendencioze dhe me qëllime të caktuara ndaj kompanisë sonë, jo vetëm në këtë procedurë prokurimi.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

- Te aprovohet ne tërësi ANKESA si e bazuar
- ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për aktivitetit të prokurimit
- DETYROHET AK- Komuna e Suharekes që të rekomandoi për Nënshkrim të Kontratë GOE: BVL KO (Lendrit Kokollari B.I.); REXHA SHPK
- Te merren masa ndaj zyrtarve te involvuar ne kete procedur.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

GOE BVL KO (Lendrit Kokollari B.I.); REXHA SHPK, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të tij ekonomike dhe ligjore, njofton se, në rast të vazhdimit të veprimeve të kundërligjshme nga Autoriteti Kontraktues, do të shfrytëzojë të gjitha mjetet juridike të lejuara sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës. Njëkohësisht, GOE rezervon të drejtën që pranë organeve kompetente të paraqesë kërkesë për kompensimin e dëmit, duke përfshirë edhe fitimin e humbur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

v10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit."*
- b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*